



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS NOVOBËRD

Numri i lëndës: 2023:211871

Datë: 02.04.2024

Numri i dokumentit: 05530352

CPK.nr.11/24
P.nr.639/23

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Dega Novobërdë, Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit G.A, duke vendosur në procedurën përbarimore të kreditorëve P. /S./ S, dhe V. /S./ S nga fshati K. K. N, të cilët i përfaqëson Av. S. R. nga Gjilani, kundër Q. së R. së Kosovës – M. e M. dhe P. H me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson A. Sh, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, të datës 22.09.2023, jashtë seancës më dt. 02.04.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

I. Apropohet si i bazuar prapsimi i datës, 22.09.2023 i Q. së R. së Kosovës – M. e M. dhe P. H me seli në Prishtinë, kundër Urdhërit Përbarimor P.nr 639/23, të datës 12.09.2023.

II. Shfuqizohet Urdhri Përbarimor i Përbaruesit Privat, K. M nga Gj. P.nr 639/23, të datës 12.09.2023.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat K.M nga Gj. me Urdhërin Përbarimor P.nr 639/23, të datës 12.09.2023, ka lejuar përbarimin e propozuar nga kreditori P. /S./ S, dhe V. /S./ S në fshatin K. K. N., kundër debitorit Q. së R. së Kosovës – M. e M. dhe P. H me seli në Prishtinë për përmbushjen e borgjit në vlerë prej 4,361.96€, në emër të kamatës vjetore e cila është llogaritur nga eksperti B. S, për shumën prej 26,509.50€, për shkak të shpronsimit të parcelave 03604-2, 03604-3, 03272-2 dhe 02828-2, ZK. Koretisht.

Përfaqësuesja e debitorit-A. Sh pas pranimit të Urdhërit Përbarimor, P.nr 639/23, të datës 12.09.2023, në afatin ligjor ka paraqitur prapësim me datë 22.09.2023, duke theksuar se dokumentet e besueshme Vendimi Përfundimtar dhe Akti i Vlerësimit nuk kanë karakterin e titullit përbarimor dhe se nuk hyn në grupin e dokumenteve të besueshme pasi që nuk kanë vulën e plotfuqishmërisë dhe të ekzekutimit, ashtu siq parasheh neni 22 i LPP-së, Vendimi Përfundimtar Nr. 09/115 i datës 17.12.2019, në asnjë nga pikat e tij nuk ka paraparë kamatën prej 7%, andaj gjykatës i kanë propozuar që të merr aktvendim që të aprovojë prapësimin si të bazuar dhe ta shfuqizojë Urdhërin Përbarimor P.nr 639/23, të datës 12.09.2023.

Nga provat që i prezenton kreditori Vendimi përfundimtar nr.09/115 të datës 17.12.2019, dhe Akti i Vlerësimit nga Ministria e Financave, Departamenti i Tatimit në Pranë, nuk mund të zhvillohet procedura përbarimore dhe nuk ka bazë ligjore sipas LPP-së, sepse propozuesi është kompensuar sipas këtij vendimi në procedurën administrative, ndërsa kamata nuk është pjesë e Vendimit Përfundimtar.

Përfaqësuesi i kreditorëve në afatin e paraparë ligjor me datë 28.09.2023, ka paraqitur përgjegje në prapësim, duke theksuar se i kundërshtojmë në tërësi pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim dhe të njëjtat nuk qëndrojnë, pasi që propozimi bazën e tij e ka në Vendimin përfundimtar Nr. 09/115 të datës 17.12.2019, i cili është lëshuar në procedurën e shpronësimit nga debitori e i'a kishte dorëzuar kreditorit. Dokumentet përbarimore si vendimi përfundimtar dhe akti i vlerësimit janë dokumente përbarimore sipas nenit 22 dhe nenit 29 të LPP-së, pasi që janë dokumente origjinale të lëshuara nga vet debitori. Është e vërtetë se Vendimi Përfundimtar nuk parasheh kamaten por këtë e ka specifikuar Ligji mbi Shpronësimin ku në nenin 16 paragrafi 2 parashihet *“Organi Shpronësues ia paguan, ose kërkon nga parashtruesi i kërkesës ose Përfituesi i prituri – nëse ka të këtillë – që t’ua paguajë shumën e kompensimit të përcaktuar në Vendimin Përfundimtar, Pronarit të prekur ose Zotëruesit të Interesit. Kompensimi i kërkuar në Vendimin Përfundimtar do të jetë: 2.1. shuma e përcaktuar në aktin përkatës të vlerësimit plus; 19 2.2. interesi në atë shumë i cili është akumuluar duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të Vendimin Përfundimtar deri në datën e pagesës. Ky interes akumulohet në shkallë prej shtatë për qind (7%) interesi i thjeshtë vjetor dhe kapitalizohet në bazë vjetore.*

Gjykatës i ka propozuar që ta refuzojë në tërësi prapësimin e debitorit dhe ta detyrojë debitorin që të paguajë shpenzimet e procedurës, të krijuara me rastin e përpilimit të përgjegjes në prapësim.

Gjykata pas shikimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, duke marrë për bazë natyrën e kërkesës, e aprovoi si të bazuar prapësimin e debitorit, pasi që Vendimi Përfundimtar nr.09/115 të datës 17.12.2019 si dhe Akti i Vlerësimit të datës 26.11.2018, në asnjërin nga pikat e tyre nuk e kanë përcaktuar kamaten vjetore prej 7%, andaj edhe nuk i plotson kriteret-kushtet në këtë rast, për të qenë dokument përbarimor sipas nenit 22 par.1 pika 1.2 të LPP-së, sa i përket kërkesës për pagesën e kamatës.

Procedura përbarimore zbatohet duke marrë për bazë parimin e rigorozitetit në procedurë, andaj dokumenti përbarimor i plotson kushtet për të qenë dokument përbarimor aso jo sipas nenit 22 të LPP-së, në këtë rast natyra e kërkesës ka të bëjë me pagesën e kamatës vjetore prej 7% të borgjit kryesor, e cila në parim si kërkesë nuk është përcaktuar sipas dokumentit përbarimor. Në procedurë përbarimore nuk mund të llogarisim kamaten e cila nuk është paraparë-njohur me dokumentin përbarimor, si kërkesë aksesore.

Nga të cekurat më lart e në pajtim me nenin 22, 71, 72 dhe 73 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN- Dega në Novobërdë
Departamenti i Përgjithshëm

CPK. nr.11/24 , Më datë 02.04.2024

Gjyqtari
G. A

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, brenda 7 ditësh nga dita e pranimi të këtij aktvendimi. Ankesa në kopje të mjaftueshme dorëzohet përmes Gjykatës Themelore në Gjiilan-Dega Novobërdë.